



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4877 Prot.

Roskovec, më 01.07 2024

VENDIM

NR 35 .DATË 26.06 .2024

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN MAJ 2024”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.05.2024, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Maj 2024.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3969/1 Prot.

Roskovec, më 30.05.2024

Procesverbal Nr.6

*-I mbajtur sot, datë 29.05.2024, ora 13<sup>00</sup>, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Prill 2024.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Prill 2024.
5. Për krijimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si edhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij për vitin 2024-2026.
6. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2023.
7. Për miratim fonde shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024.
8. Për përditësim në listën e inventarit, miratuar me VKM-në Nr.108 datë 17.02.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kurjan, Bashkia Roskovec".
9. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13<sup>05</sup>

Këshilltarët prezent: A.Plaka, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, P.Toro, A.Hoxha, A.Pelo, S.Bibo Qamili, F.Feëeqi.

Këshilltarët që mungojnë: E.Musko, E.Çepele, Rr.Hazizi, Zh.Metushi, J.Begaj, V.Çepele.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomisë, P/Shërbimit Social, P/Dr.së Integritimit European dhe Marrdhënieve me Publikun.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 14 këshilltar. Kryetari i falenderon për pjesmarrjen. Dua tju bëj një njoftim përsa i takon rendit të ditës. Pika 5 e rendit të ditës, pas rishqyrtimit bashkë me zyrën përkatëse, është vënë re se do të kaloj në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak si informacion për krijimin, kriteret dhe procedurat e

përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, pasi ekziston një vendimmarrje dhe nuk ka nevojë detyrimisht për një vendimmarrje të re mbi Vendimin e Këshillit që ekziston. Pra kjo pikë nuk do të nënshtrohet vendimmarrjes. Pika 8 është tërhequr nga zyra përkatëse për plotësim, pasi në vitin 2023 ka dal një Vendim i Këshillit të Ministrave, i cili detyron plotësimin me pjesë dokumentare, dhe besoj që kjo pikë do të kalojë në mbledhjen e ardhëshme të Këshillit Bashkiak, pasi nga zyra përkatëse të plotësohet me dokumentacionin dhe të përshtatet sipas këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave.

### 1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës duke përfshirë ndryshimet e përmendura më sipër dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

Fredi-në mbledhjen e kaluar e lam për raportin e KLSH-së, që të ishte një pikë e rendit të ditës, informacion dhe diskutim i raportit të KLSH-së, dhe nuk na erdhi materjali këtë herë. Ta lëm për në mbledhjen tjetër një pikë të rendit të ditës. Kryetari-nuk e shikoj fare problem këtë pjesë, se diskutim është kjo, që mund ta beni edhe sot. Unë nisa tju shkruaja dhe po ju sqaroja që raporti i KLSH-së e para njëherë kemi dy situata, raporti me të cilin ne ju kemi pajisur është raporti i kaluar, dhe ju në kërkesën tuaj këtij raporti i referoheni. Në momentet që ne flasim Bashkia Roskovec është në auditim nga KLSH-ja, dhe janë duke u verifikuar detyrat e lëna nga kontrolli. Në këtë moment vjen këshilltarja E.Toska, prezent u bënë 15 këshilltarë. Kryetari-KLSH-ja është institucion i pavarur dhe raportet e tij nuk janë raporte që prodhohen nga institucioni i Bashkisë Roskovec. Si të tilla këto raporte ju mund ti gjeni lehtësisht në faqen zyrtare të KLSH-së dhe në faqen tonë zyrtare. Nuk mund të themi që kemi qënë të panjohur, përse kohë raporti është publik. Pra këtë informacion mund ta gjeni lehtësisht dhe në faqen e KLSH-së dhe në faqen e Bashkisë Roskovec që ka linkun përkatës, që mund ta shikojë apo printojë kush të ketë dëshirë. Është publik si informacion, jo i rezervuar.Fredi-se paragjykojë njeri.

### 2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Prill 2024.

Nuk ka pyetje dhe diskutime në lidhje me informacionin.

### 3..Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari-besoj që të gjithë jeni njohur me procesverbalin, keni qënë të pranishëm në mbledhje, keni gjetur dhe pjesën e diskutimit tuaj në këtë procesverbal. Amarildo-para se ta kaloni në votim, ne do japim arsyet pse jemi kundër këtij procesverbali të mbledhjes së kaluar, për arsyen e vetme sepse ajo mbledhje, siç e kanë parë të gjithë qytetarët, ka qënë një maskaradë, ka qënë një mbledhje ku këshilltarët pa përjashtim janë kërcenuar, janë shantazhuar për ta kaluar. Dhe siç e dini dhe siç e keni parë, provat dhe faktet me zë dhe me figurë kanë treguar që ajo mbledhje ishte e stisur, dhe të gjitha provat dhe faktet po dalin dita ditës. Unë kam një falenderim të veçantë për të gjithë banorët e Sukut, pa përjashtim dhe bindje politike, janë bërë bashkë kundër kësaj të keqeje të madhe që u ka ardhur në derën e shtëpisë. Kam një falenderim të veçantë për z.Sazan Guri që ka qëndruar në krahun e qytetarëve dhe në të drejtën e tyre. Një falenderim i veçantë shkon dhe për avokatin Altin Goxhaj, që kam bindjen që do na përfaqësojë dhe do e fitojmë këtë çështje, por mbi të gjitha kam një këshillë. Të gjithë kështu siç jemi bashkarisht, duke parë provat dhe faktet që po dalin dita

ditës, dhe të gjithë do jenë në ndjekje penale, këtë ua garantoj me bindje të plotë, sepse nuk mund të fshihet më. Do u kërkoja të gjithëve sinqerisht, të kërkojmë një falje ne si këshill, sepse është turp për këtë këshill në 33 vjet demokraci, të kalojmë këtë vendim që kemi kaluar radhën e kaluar. E kam shumë sinqerisht, pa bindje politike, pa asnjë lloj inati. Ju e shikoni vet se çfarë po ndodh, dita ditës po dalin prova dhe fakte që atje është manipuluar, atje është vjedhur, atje janë tjetërsuar pronat. Kryetari-faleminderit Z.Amarildo, gjithkush mendoj se ka mënyrën e vet të të gjykuarit, gjithkush zgjedh mënyrën e vet të të folurit, që të ruanit pak etikën do te ishte shumë mirë, dhe jo vetëm brenda kësaj salle, sepse ne jemi qytetarë të përgjegjshëm. Elizabeta-sidomos në rrjetet sociale të ruajnë etikën, kanë ulur, kanë fyer figurën e femrës, të nënës, të intelektuales me fyrye nga më të ndryshmet. Kryetari-ju lutem të ruani etikën jo vetëm brenda kësaj salle, por mendohet që jeni qytetarë edhe ju, dhe në fund të fundit gjithsecili fytyrën e vet tregon, prandaj do ju lutem të kemi pak etikë dhe ti referohemi rendit të ditës, është shumë e qartë pika e rendit të ditës. Amarildo kërkon fjalën. Kryetari-ua dhashë fjalën dhe ju folët atë që deshët, në kundërshtim me pikën që po diskutojmë. Amarildo-ne si opozitë këtu, nuk i kemi bërë thirrje askujt në rrjete sociale të shantazhoj, të ofendoj, aq më keq femrat. Kryetari-përgjigjen gjithsecili do ta marrë aty ku duhet. Maksi-po qe se e keni bërë ju dhe merrni autorsinë? Dhurata-cilën autorsi, për të mbrojtur të drejtën tonë? Maksi-nuk besoj se e merrni autorsinë. Dhurata-jo, ska lidhje fare me ne. Emels-Kryetar sapo bëre një akuzë që the e keni bërë ju, dhe tani ne jemi këtu për tu distancuar nga ajo lloj gjuhe, nuk jemi ne pjesë e asaj gjëje, se po të ishim do ta kishim bërë që këtu dhe jo në rrjete sociale, dhe Elizabeta bën mirë ti tërheqi të gjitha ato që tha. Ça thuhet nëpër rrjete sociale janë qytetarë që janë të indinjuar për një apo shumë arsye të vetat, kështu që nuk kemi lidhje ne me atë që thotë Elizabeta dhe na etiketon ne si të tillë, mos të na tregosh këtu figurën e gruas, nënës. Kryetari-Elizabeta të lutem do të doja shumë që në momentin e caktuar ta diskutonim dhe këtë gjë, përgjigjen nuk po ja jap për replikë Z.Melsi, sepse kur unë thashë ju, iu referova gjuhës së përdorur këtu në këtë sallë, dhe jashtë mesa unë kam dëgjuar, ju lutem të vazhdoni me rendin e ditës. Fredi kërkon fjalën. Kryetari-nuk mund të vazhdojë kështu kjo mbledhje, sepse ne jemi për të respektuar këtë rend dite që kemi miratuar bashkarisht, dhe nuk po ua heq njeri të drejtën e fjalës, do i diskutojmë. Fredi-e drejtë fjale është edhe kjo, ta hedhim në votim pa marrë fjalën? Amarildo-kemi të drejtë të flasim sepse na u përmend emri. Zonja tha që na kanë ofenduar, ne nuk kemi qënë dhe nuk jemi kurrë kundër bindjeve të njëri-tjetrit, ne jemi plotësisht kundra dhe distancohemi nga këto. Elizabeta-është plotësisht e drejtë që secili të shprehë mendimin e tij. Amarildo-ne jemi këtu për të bërë atë që na takon, për të cilën na kanë sjellë këtu qytetarët.Problemi qëndron jo tek ajo që tha Elizabeta, sepse ne atë pjesë e thamë jemi kundër dhe distancohemi, nuk kemi asnjë lloj urrejtje dhe fyerje për kolegët tanë, por problemi qëndron që ne nuk po gjejmë dot zgjidhjen se na kanë pyetur edhe qytetarët, dhe atë formulën që keni gjetur jo ju, por ata zotrinjtë e tjerë, që kanë ngjallur të vdekurit për të varrosur të gjallët në këtë vend, sepse siç e keni parë aty kanë firmosur njerëz që kanë ndërruar jetë. U kërkoj ndjesë familjarëve të tyre që po i përmend, dhe aty kanë firmosur njerëz që nuk e dinë as vet për çka kanë firmosur, dhe të gjithë e kanë dëgjuar që ata zotrinjtë kanë firmosur për panele diellore, ata që kanë qënë prezent dhe kanë firmosur atë paçavure procesverbal, dhe jo të jenë informuar për këtë termocentral në fshatin e tyre, apo zonën e tyre. Për këtë jemi këtu ne, jo për të shantazhuar apo bërë presione, as për të ofenduar. Fredi-ne jemi ruajtur që të ruajmë etikën, por nuk mund të rri unë pa përmendur mbledhjen e këshillit të kaluar, ku ne si këshilltarë jemi deningruar. Unë kam 20 e ca vjet anëtar këshilli, drejtim mbledhje që të thoshte Kryetarja e Bashkisë, që të drejtonte, të bente presion, jepja fjalën ose mos ja jep

fjalën, të arrijë deri aty sa e kishte thirrur inxhinieren përkatëse për të sqaruar për vendimin e këshillit, sepse për atë ishte thirrur, nuk ishte thirrur si kukull aty, dhe për presion nuk e la të fliste. Këshill me të deningruar se ajo mbledhje, unë kam 20 e ca vjet e nuk e kam parë asnjëherë, dhe ne ndihemi të ofenduar. Kishin ardhur 5 furgona policie sikur ne jemi kriminela. Ne jemi munduar, pavarësisht mënyrës së votimit, do ta tregojmë kemi pasur të drejtë apo skemi pasur të drejtë, as kemi paragjykuar, kemi ruajtur etikën edhe këtu, edhe me Kryetaren, por kemi qënë të ofenduar. Këtu është zyra e Këshillit jo e Bashkisë, nuk jemi thirrur këtu për të bërë palaçon e Kryetares së Bashkisë. Ta kryesojë Kryetari, Nënkryetari i Këshillit mbledhjen, jo Kryetarja e Bashkisë. Kryetari-asnjë këtu nuk e ka sjellë dhe nuk e kemi thirrur, janë zgjedhësit që kanë përcaktuar praninë tonë në këtë sallë, dhe çdo njeri nga ne ka arsyen e vet, ka bindjen e vet, ka dinjitetin e vet dhe nuk ka nevojë ta mësojë askush tjetër në këtë sallë sesi duhet të sillet dhe si duhet të veprojë. Leksi-nuk kisha ndërmend për të folur rreth kësaj çështje që hapën kolegët, nuk diskutohet që ata nuk janë iniciatorët ose frymëzuesit e atyre që kanë sharë në rrjetet sociale, komente mbase mund të kenë bërë, por problemi është që votimi që është bërë këtu dhe akuzat që ngrihen ndaj nesh, nuk është se u bënë nën presion. Unë jam i ndërgjegjshëm, kam ardhur nga një pjesë që më kanë votuar dhe i përgjegjshëm për atë që votoj. Të paktën dhe kolegët tanë e dinë që demokracia ka një normë, ka vetëm votat. Unë jam në Roskovec lindur dhe rritur dhe skam ndërmend të largohem nga Roskoveci, kështu që nëse e marr këtë vendim, unë nuk e marr kundër vetes time, por për një zhvillim. Të shahemi e deningrohemi ne që jetojmë në Roskovec dhe falenderohet eksperti Sazan Guri apo Altin Goxhaj që ata jetojnë në Tiranë, dhe flasin ata për Tecin nuk është normale. I falenderoj kolegët e opozitës që të paktën u distancuan nga sharjet dhe fyerjet, por të paktën për shitje dhe blerje midis nesh nuk ka pasur, dhe unë them që ata ta tërheqin këtë pjesë, sepse edhe ne jemi familjarë dhe fyhemi në këtë rast. Dhurata-Leksi faleminderit për etiketimin që bëre për z.avokat Altin Goxhaj dhe Sazan Guri ambientalistin, ata nuk ishin njerëz të rrugës, dhe sigurisht ju keni mendimin tuaj, ndoshta skeni qënë të manipuluar, por ta keni të qartë që keni cënuar jetën e gjithë banorëve të Sukut, në radhë të parë mua si kolegja juaj që jam 650 m larg nga ai Tec që do ndërtohet, dhe jo për dëshirën tuaj jam e bindur, por të dy firmave, për dy persona dhe kjo është makabër, dhe populli këtë nuk ka për t'ju falur. Ndaj mos na etiketoni ne që thoni që juve keni futur të tjerët për ato mesazhe, se nuk jemi në atë nivel kulturor, këtë ta keni të qartë. Na keni cënuar dinjitetin, pse të bredhim ne në SPAK, për çfarë, për dy persona hajduta, për dy kriminela? Pse njerez pa punë jemi ne? Pse të vuajmë ne, të vuaj ai popull i Sukut atje, pse të bredhim rrugëve të Tiranës, 70 veta pardje për të dorëzuar dosjen. Amarildo-ne nuk kemi asgjë kundër kolegëve, e kam të faktuar me zë dhe figurë që anëtari i këshillit të majtë e ka kundërshtuar herën e parë këtë projekt-vendim, dhe herës tjetër ka votuar, ndaj i qëndroj asaj që them, janë shantazhuar, jo të gjithë por një pjesë, dhe i është bërë presion për ta votuar, kjo është me zë dhe figurë. Maksi-sa i përket mbledhjes së parë, ju hodhët akuza që u bë në terror dhe presion, po ju them që nga ana e ekzekutivit nuk ishte marr asnjë lloj mase si brenda sallës dhe jashtë për ndonjë presion. Falenderoj në emër të ekzekutivit distancimin tuaj nga fjalët e urrejtjes në rrjetet sociale. Sa i përket vendimmarrjes, kjo është një vendimmarrje që koha dhe gjykata do ti japi të drejtën. Ju i jeni drejtuar një instance, kur flet gjyqësori nuk ka nevojë të flasin gjithë të tjerët. Sekretarja sqaron në lidhje me procesverbalin. Ky procesverbal është bërë ashtu siç e kërkoi Dhurata mbledhjen e kaluar, dhe është çfarë ndodhi atë ditë, ju nuk po miratoni vendimin prapë. Amarildo thotë që jemi kundër procesverbalit, ka ndonjë gjë tepër apo mangët? Ju po miratoni atë çfarë u bë, jo vendimin. Emels-janë disa gjëra mangut aty kur kemi pyetur kryetaren, përgjigjet e

kryetares. Sekretarja-përgjigjet e kryetares janë shkruar, dhe kur flisni ju pa leje unë jam munduar që ti shënojë të gjitha në procesverbal, por me rregullore nuk kam të drejtë ti shkruaj kur ju flisni pa leje, dhe nuk e kam vetëm për pjesën sot. Emels-mos thuaj kështu si flisni ju pa leje, se flet gabim. Sekretarja-e kisha për të gjithë këshilltarët. Fredi-nuk të paragjykuam për asnjë gjë, as procesverbalin, as të shkruarën sepse ti shkruan shumë shpejt dhe ke arritur ti kapesh, por drejtimin e mbledhjes dhe presionin e Kryetares. Sekretarja-unë kap thelbin e mbledhjes. Kryetari-është çdo gjë e regjistruar, unë jam kujdesur personalisht që mbledhjet të regjistrohen dhe transmetohen live. Sa i takon shkathtësisë së sekretares, ju lutem të mos merreni me komente të tilla sepse është pjesa e regjistruar e cila e ndihmon për të qënë shumë korrekte. Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet me 9 vota pro, 6 vota kundër nga koalicioni BF.

4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Prill 2024.

Sidorela sqaron projektvendimin. Fredi-a është zbatuar vendimi i Kryetares së Bashkisë për afishimin e listës në qendrat administrative? Sidorela-po është zbatuar. Fredi-unë isha në Qendrën Administrative Kurjan, dhe të falenderoj sepse komunikuam bashkë, sepse ajo punonjësja atje nuk mu përgjigj mirë, ata na paragjykojnë mbase, por meqë ju jeni këtu po e them, sepse janë hequr nga ndihma ekonomike persona që nuk kanë arsye të hiqen, padrejtësisht. Tu heqësh bukën e gojës njerëzve për arsye politike, sepse është një fakt që në muajin Maj të vitit të kaluar kanë qënë 170 persona dhe në muajin Maj tani 112 persona. Të gjithë kanë vajtur sepse unë kam pyetur pjesën dërrmuese të njerëzve që janë hequr, që u takon. Meqë jeni ju përgjegjëse, e shikoni me korrektësi sepse është gjynah të heqësh bukën e gojës. Të gjithë i përkasim forcave politike, por nuk jemi në vendin e punës ku jeni ju, apo ajo punonjësja tjetër që ishte atje, për tjua hequr, është gjynah. Unë nuk e imagjinoj dot, kam 20 e ca vjet anëtar këshilli, të ngrihem pse merr ai ndihmë ekonomike, dhe këtu kur e kam parë që kanë qënë padrejtësisht, prapë nuk e kam thënë, shoqërore dhe mund ta kemi thënë, por në qoftë se do vazhdohet kështu, të kërkoj personalisht të merresh. Nëse do vazhdohet kështu do bëheni pjesë e emisioneve investigative, do ju vij hidhur edhe ju, edhe njerëzve. Amarildo-siç e preku edhe Fredi pak më parë pjesën e komunikimit të nënpunësve të bashkisë dhe njësive administrative, doja të falenderoja për atë komunikim që ke pasur me Fredin, sepse kemi biseduar dhe ke qënë korrekte. Meqënëse është dhe Nënkryetari i bashkisë Maksi, kam një thirrje sepse kemi ankesa dhe nga qytetarët, ka një arrogancë sjellja e punonjësve të bashkisë me qytetarët. Mos ta mendojnë se janë aty për interesa politike apo se i ka çuar partia dhe karrigen e kanë të tyren, janë aty për tu shërbyer qytetarëve dhe tu shpjegoni që paguhen nga ata qytetarë për të ndenjtur në ato zyra, dhe jo ti bëjnë karshillëk qytetarëve kur vijnë aty, por ti japin shërbim, informacion dhe ti sqarojnë për çfarë vijnë, sepse nuk është rasti i vetëm ky që po flasim sot, por është rasti i përsëritur që na vijnë denoncime të qytetarëve. Përderisa një nënpunës i bën karshillëk dhe një anëtar të këshillit të bashkisë, mendoni vet se çfarë i bën një qytetari. Se kuptoj nga vjen kjo arrogancë, jam i befasuar. Këta zotrinjtë nuk e kuptojnë se janë aty për tu shërbyer qytetarëve, do marrin dhe rrogën për ta çuar tek fëmijët e tyre. Si e mendojnë këta, që i ka çuar partia dhe këta do ta mbajnë me sesbën atë? Jo mor zotri, në rast se nuk do ketë ndryshim të sjelljes së tyre, ta dini shumë mirë që do keni përditë kamera nëpër zyra, ne vet do ti bëjmë këto investigime, dhe do i nxjerrim nga puna ata që sillen në këtë mënyrë, dhe do u heqim kapelen të gjithë atyre që u përgjigjen qytetarëve, pavarësisht bindjeve politike majtas apo djathtas. E kanë detyrim ligjor. Nuk

e kuptoj nga e kanë këtë arrogancë? Ndoshta më falni, dhe nga injoranca sepse mendojnë se atë karrige e kanë të tyre, jo mor jo se kanë të tyren, shumë shpejt mund të lëvizin. Maksi-sa i përket problemit të parë të Fredit, lëvizjet nga ndihma ekonomike nuk janë kompetencë e punonjësit të ndihmës ekonomike të bashkisë apo njësisë administrative. Janë kompetencë e sistemit, të cilat kontrollohen, verifikohen në bazë të dokumentacionit që ata paraqesin për të përfituar ndihmën ekonomike. Atje ku sistemi kap shkelje të deklarimeve, qoftë dhe verifikimin në vend te familjet, atëherë i heq sistemi, jo punonjësit e ndihmës ekonomike. Sa i përket problemit të dytë, nëse ju falenderoni dhe pastaj hidheni në akuzë për punonjësit e administratës, unë jam këtu për të mos qënë dakort me ju, e gjithë administrata e bashkisë nuk është me këtë qëndrim arrogant që thoni ju, nëse keni fakte na i jepni dhe ne do të mbajmë qëndrimin tonë. Fredi-ta them unë meqë e the, kërkova dhe vajta për të marr informacion. Amarildo-tu vij turp, janë injorant dhe përfaqësojnë zyrën e shtetit. Kryetari-Z. Amarildo të lutem po i pret fjalën këshilltarit tjetër, të lutem pak më i qetë. Maksi-unë si Nënkryetar i bashkisë nuk e pranojë në mënyrë kategorike tu thuash punonjësve të administratës së bashkisë injorant. Amarildo-atje ku u takon ta them, i them dhe faleminderit atij punonjësi që e pret qytetarin në zyrë dhe e trajton me dinjitet, jo ta nëpërkëmbi. Maksi-nëse keni ankesë me fakte thuaje, por mos fol në përgjithësi. Amarildo-do ti sjellim me fakte, sepse nuk ndryshojnë këta tipa. Fredi-sdoja ta bëja publike, por meqë ti e the, thashë komunikova me atë, skam turp ta falenderoj për atë që bën, dhe skam turp ta them dhe për atë që bëri ajo tjetra, skam frikë. Mos më thuaj pse, sepse unë e mbylla me atë dhe prandaj e falenderova, nuk donte të më jepte informacionin, e ka detyrim ligjor, të më thotë mua ik merri jashtë atje ku është afishuar. Maksi-dhe për këshilltarin ka ligje për të dhënë informacion. Ju ndaloj në mënyrë kategorike tu thuash punonjësve injorant. Fredi-nuk e thashë unë injorant. Amarildo-e them sërish në rast se nuk e presin qytetarin në mënyrën e duhur, e kanë detyrim ligjor, për atë paguhen. Kryetari-Z. Amarildo po ju tërheq vëmendjen për fjalorin e përdorur, është hera e disajt. Amarildo-dhe ty si Kryetar të bëj thirrje shumë të sinqertë, që të trajtohen qytetarët me dinjitet dhe me respekt. Kryetari-o zotri nuk je ti Mesia që jep paqe, mend dhe drejtësi për të gjithë, ti je një këshilltar si puna ime, të lutem respekto vendin tënd dhe të lutem të zgjedhësh fjalorin e duhur. Amarildo-po flas në emrin tim, sepse është e disajta herë që vijnë informacione nga qytetarët. Dhurata-Maksi të bëj një pyetje, në Njësinë Administrative Strum ka internet? sepse ata refuzojnë të bëjnë fotokopje se thonë që skemi internet, e kam rast të freskët fare. Maksi-ka internet. Dhurata-atëherë mund tja bëni një vërejtje, nuk dua ta bëj publike por e kam rast të freskët fare brenda familjes. Maksi-ka raste të veçanta kur ska internet, por jo që ska fare internet. Emels-ça ka ndodhur sepse në periudhën Maj të vitit të kaluar kanë qënë 170, dhe në periudhën Maj të këtij viti janë 112, rreth 58 familje që janë më pak në ndihmën ekonomike, apo thjesht ishte vit elektorale dhe përfituan ca familje më tepër, dhe sivjet këta janë skualifikuar? Maksi-në mënyrë kategorike nuk kishte lidhje me vitin elektorale. Është kontrolluar sistemi dhe dokumentat e paraqitura. Nuk janë paraqitur personat që marrin ndihmë ekonomike se janë në emigracion, dhe po nuk firmosën nuk marrin dot ndihmë ekonomike. Ne mund ti japim me emra dhe fakte. Sidorela-disa familje janë djegur sepse nuk janë paraqitur për të bërë deklarinimin 3 mujor, disa nuk kanë deklaruar pensionin, disa nuk kanë deklaruar që kanë bërë një martesë në familje, dhe disa familje janë skualifikuar nga vizitat në familje sepse kanë qënë me të ardhura. Emels-se kanë fshehur televizorat dhe frigoriferat? Kryetari-smund të ikim me këtë bazë paragjykuese për çdo lloj gjëje. Emels-unë kam paragjykimet e mia, se kur specialistja thotë që ekipi ka shkuar tek familja e dikujt atje dhe thotë nuk e përfiton, kush është arsyeja? sepse ka pas televizor brenda në shtëpi dhe frigorifer, kaq? Këto sjanë kritere, dhe si ka mundësi që ndodh

gjithmonë që janë disa familje që hiqen nga ndihma ekonomike sa herë që ka zgjedhje dhe nuk i përkasin të njejtës familje politike? Maksimund ta diskutojmë këtë por jo në këtë mbledhje, dhe ti jap me emra kush janë, dhe shikoje janë të djathtë apo të majtë, se mund të jetë pjesa më e madhe e majtë. Kryetari-z.Maksi ju tërheq vëmendjen edhe juve sepse unë nuk mund të lejoj që në këtë mbledhje këshilli të trajtohen qytetarët tanë, që janë të barabartë përballë bashkisë Roskovec, përballë ligjit dhe përballë çdo lloj gjëje, të trajtohen si të majtë dhe të djathtë. Këta janë qytetarët tanë, ata që na kanë besuar, dhe do ju lutesha sinqerisht që të mos ikim me këtë idenë e parimit për çdo lloj gjëje. Nëse dikush mendon që këta specialistë nuk kanë përdorur kriteret siç duhen, kanë abuzuar me ato, i kërkojmë një raport të thelluar me emra, i marrim në analizë, le të shkojë dhe një grup këshilltarësh ti riverifikojë të njëjtat kritere që ka përdorur specialisti, por ne nuk mund të ikim me idenë që se ka bërë mire /e ka bërë mirë, dhe ta zgjidhim me një thashethemnjë të madhe në këtë mbledhje këshilli. Në këtë mbledhje ne jemi për të miratuar këta emra që nuk ishin fare të ndihmës ekonomike, dhe po diskutojmë jashtë rendit të ditës. Nëse ju mendoni se ajo listë është shkurtuar duke mos respektuar cilësimet ligjore për të, të diskutojmë në një forëm tjetër, se nuk mendoj që e zgjidhim duke etiketuar qytetarët tanë, të cilët janë pjesa më hallexhie e shoqërisë. Emels-unë kur nisa fjalën time,nuk thashë që pse e përfitojnë këto familje të majta, unë jam që ta përfitojnë sa më shumë. Nëse kanë qenë 170 edhe 200 lër të jenë për arsye sepse është pjesa më e prekur e shoqërisë, pak rëndësi ka nëse janë të majtë apo të djathtë. Unë thashë pse nuk e përfitojnë edhe këta që kanë qenë pjesë e ndihmës ekonomike. Kryetari-dua tju bëj me dije se sektori që merret me këtë pjesë, është pjesë e auditimit, dhe auditimet kanë sistemet e veta të kontrollit, dhe në qoftë se njëra familje humbet pikëzimin për shkak të kriterëve të vendosura, nuk mund të vazhdojë ti lëri thjesht për të ruajtur numrin, sepse këto mbajnë përgjegjësi ligjore për faktin që dikush tejkalon përcaktimet ligjore dhe vazhdon të jetë në skemën e ndihmës ekonomike. Hidhet në votim projekt-vendimi dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro. Dhurata-unë në emër të grupit do ju falenderoja për debatet që ju menduat që ne i kishim të paqenësishme, dhe në shenjë proteste ne të grupimit Bashkë Fitojmë po largohemi, si dhe për mbledhjen e kaluar për të cilën ne jemi të indinjuar. Të 6 anëtarët ngrihen dhe largohen nga mbledhja pa firmosur. Kryetari-duhet të keni parasysh që përfaqësoni qytetarët e bashkisë Roskovec, jo vetëm për pjesën që mendoni ju se është e drejtë. Kryetari-për shkak të largimit të paarsyetuar të një pjese të këshilltarëve nga kjo mbledhje, për sa kohë kuorumi i nevojshëm për vazhdimin e mbledhjes nuk plotësohet, unë e deklaroj këtë mbledhje të mbyllur.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**

**Kryetar**

**Afrim Plaka**